



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2004 Prot

Vlorë, më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 10, datë 25.09.2025

PËR MBARIMIN E MANDATIT TË KËSHILLTARIT TË KËSHILLIT TË
QARKUT VLORE Z. JOLIO DINE

Këshilli i Qarkut Vlorë në mbështetje të Nenit 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 8, datë 28.02.2025 (Nr. 1557 Prot, datë 05.03.2025) “Për deklarimin e mbarimit para afatit, të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z. Jolio Dine”,

VENDOSI:

1. Të miratojë mbarimin përpara afatit, të mandatit të këshilltarit të Këshillit të Qarkut Vlorë Z. Jolio Dine.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. _____ Prot, datë _____.2025.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë është protokolluar me tonën Nr. 1755 Prot, datë 29.08.2025, shkresa e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 6284 Prot, datë 25.08.2025, me lëndë "Përcjellje vendimesh për zëvendësimin e dy anëtarëve të Këshillit Bashkiak Sarandë në Këshillin e Qarkut Vlorë", bashkëlidhur së cilës gjendet dokumentacioni i Këshillit të Bashkisë Sarandë i cili më datë 28.03.2025 ka marrë në shqyrtim zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Sarandë si përfaqësues në Këshillin e Qarkut Vlorë pas dorëheqjes së Z. Jolio Dine si anëtar i Këshillit Bashkiak Sarandë (mbledhja e datës 28.02.2025).

Në dokumentacionin e dërguar ndodhen:

1. Shkresa e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 6284 Prot, datë 25.08.2025, me lëndë "Përcjellje vendimesh për zëvendësimin e dy anëtarëve të Këshillit Bashkiak Sarandë në Këshillin e Qarkut Vlorë".
2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 8, datë 28.02.2025 (Nr. 1557 Prot, datë 05.03.2025) "Për deklarimin e mbarimit para afatit, të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z. Jolio Dine".
3. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 34, datë 28.03.2025 (Nr. 2154/2 Prot, datë 02.04.2025) "Zgjedhjen e anëtarit që do të përfaqësojë Këshillin e Bashkisë Sarandë në Këshillin e Qarkut Vlorë"

Duke parë se dokumentacioni i dorëzuar nga ana e Këshillit të Bashkisë Sarandë është i plotë, bazuar në Nenin 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ju ftojme që të procedojmë me miratimin e këtij vendimi.

Ju faleminderit!

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600